



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 326/3 Prot.

Tiranë, më 18.07.2017

V E N D I M

Nr. 168, datë 18/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 54, datë 06.05.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 54, datë 06.05.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat",

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 119, datë 05.11.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Berat", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Berat. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 54, datë 06.05.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Berat, si pjesë përbërëse të këtij vendimi, si dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar ligjshmërinë sipas detyrave që do të detajohen në vijim.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, "Nëpunës civil", për 42 punonjësit, të cilët përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të cilët në mënyrë analitike dhe sipas pozicioneve renditen si më poshtë:

- ✓ *****
Drejtores e Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve;
- ✓ *****
Specialist-Jurist;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Drejtores e Drejtorisë së Financës;
- ✓ *****
Specialist Auditi;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Koordinimit dhe Shërbimeve;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
- ✓ *****
Drejtor i Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialist i Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Financës;
- ✓ *****
Drejtores e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialiste-Juriste;
- ✓ *****
Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Financës;
- ✓ *****
Drejtores e Auditit të Brendshëm;
- ✓ *****
Specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- ✓ *****
Drejtores e Koordinimit dhe Shërbimeve Publike;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Koordinimit dhe Shërbimeve;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Koordinimit dhe Shërbimeve;
- ✓ *****
Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë;
- ✓ *****
Specialist i Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialiste e Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialist i Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialist i Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Specialiste e Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ *****
Drejtores e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit;
- ✓ *****
Specialist i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit;
- ✓ *****
Drejtores e Burimeve Njerëzore.

3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, në kategorinë “nëpunës civil në periudhë prove”, për 2 punonjës, të punësuar në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të cilët janë në kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilët në mënyrë analitike dhe sipas pozicioneve renditen si më poshtë:

- ✓ ***** *Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;*

- ✓ ***** Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
- ✓ ***** Specialiste në Drejtorinë e Financës;
- ✓ ***** Specialist Auditi;
- ✓ ***** Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit Social;
- ✓ ***** Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
- ✓ ***** Specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ ***** Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tregjeve;
- ✓ ***** Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tregjeve.

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, duhet të materializojë në strukturë, ndarjen e qartë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga funksionet ndihmëse administrative, sipas përkufizimeve të materializuara në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

Në vijim të realizimit të kësaj detyre, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes dhe të veprojë për përfshirjen në shërbimin civil dhe për pasojë, trajtimin si nëpunës civilë, të punonjësve që plotësojnë këto pozicione, të cilët përmbushin kushtet ligjore sipas përshkrimit të punës, duke u mbështetur në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe konkretisht, të emërtuara dhe të ndara sipas njësive administrative, si më poshtë:

- Në Njësinë Administrative Otlak, pozicionet e punës:

- ✓ "Përgjegjës i Administratës"
- ✓ "Drejtor i Financës"
- ✓ "Inspektor i Financës"
- ✓ 2 pozicionet e punës si "Inspektor i Tatim Taksave".

- Në Njësinë Administrative Sinjë, pozicionet e punës:

- ✓ "Përgjegjës i Administratës"
- ✓ "Specialist i Financës"
- ✓ "Përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Ekonomike"
- ✓ "Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave"
- ✓ "Specialist i Tatim Taksave"
- ✓ "Specialist i Auditit"
- ✓ "Specialist i Pyjeve Komunal"

- Në Njësinë Administrative Roshniku, pozicioni i punës:

- ✓ "Specialist Kadastrë"
- ✓ 3 pozicione pune si "Specialist Finance"

- Në Njësinë Administrative Velabisht, pozicionet e punës:

- ✓ 2 pozicione pune si "Inspektor Tatimesh"
- ✓ "Përgjegjës i zyrës së Ndhmës Ekonomike"
- ✓ "Administrator i Ndhmës Ekonomike"
- ✓ "Drejtor Shërbimesh"

- ✓ 2 pozicione pune si “Inspektor Pyjesh”
- ✓ “Inspektor Mjedisi”
- ✓ “Përgjegjës Urbanistike”
- ✓ “Topograf”
- ✓ “Inspektor Ndërtimi”
- ✓ “Arshiv Protokoll”

5. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, duke evidentuar faktin e mospërmbljes së kriterit të nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët janë me arsim të mesëm, ose që nuk i plotësojnë kriteret arsimore, në lidhje me nivelin e arsimit të lartë, si më poshtë:

- Në Njësinë Administrative Otllak:

- ✓ *****, emëruar me kontratë pune, datë 10.07.2011, në pozicionin “Përgjegjës Administrate”
- ✓ *****, emëruar me aktin nr. 19, datë 10.02.2010, në pozicionin “Inspektore e Tatim Taksave”
- ✓ *****, emëruar me aktin nr. 77, datë 01.12.2010, në pozicionin “Inspektor i Tatim Taksave”
- ✓ *****, emëruar me aktin nr. 30, datë 27.07.2009, në pozicionin “Inspektore e Kadastrës”

- Në Njësinë Administrative Sinjë:

- ✓ *****, emëruar me kontratë pune, datë 14.01.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike”;

- Në Njësinë Administrative Roshnik:

- ✓ *****, emëruar me kontratë pune, datë 01.07.2008, në pozicionin “Specialist Kadastrë”;

- Në Njësinë Administrative Velabisht:

- ✓ *****, emëruar me kontratë në datën 01.04.2013, në pozicionin “Inspektor Tatimesh”
- ✓ *****, emëruar me kontratë, në datën 02.04.2012, në pozicionin “Administrator i Ndihmës Ekonomike”
- ✓ *****, emëruar me kontratë, datë 15.07.2011, në pozicionin “Inspektor Pyjesh”
- ✓ *****, emëruar me kontratë, datë 02.07.2012, në pozicionin “Topograf”
- ✓ *****, emëruar me kontratë, datë 17.10.2011, në pozicionin “Inspektor Pyjesh”

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Berat.

6. Për punonjësit, të cilët u gjendën në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, që plotësojnë kriteret dhe që nuk i është deklaruar statusi i punësimit, të veprohet si më poshtë:

- Njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, “Nëpunës civil”,

✓ Në Njësinë Administrative Otllak, për punonjësit:

- ***** , emëruar me kontratë në datën 16.08.2010, në pozicionin “Drejtor Finance”
- ***** , emëruar me aktin Nr. 7, datë 16.03.2012, në pozicionin “Inspektor Finance”

✓ Në Njësinë Administrative Sinjë,

- ***** , emëruar me kontratë në datën 14.01.2013, në pozicionin “Përgjegjës Administrate”

✓ Në Njësinë Administrative Velabisht, për punonjësit:

- ***** , emëruar me kontratë në datën 01.04.2012, në pozicionin “Inspektor Mjedisi”
- ***** , emëruar me kontratë në datën 15.07.2011, në pozicionin “Arshiv-Protokoll”

- Njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, në kategorinë “nëpunës civilë në periudhë prove”,

✓ Në Njësinë Administrative Sinjë, për punonjësin:

- ***** , emëruar me kontratë në datën 14.01.2014, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”

✓ Në Njësinë Administrative Velabisht, për punonjësit:

- ***** , emëruar me kontratë në datën 03.01.2014, në pozicionin “Përgjegjëse e Ndihmës Ekonomike”
- ***** , emëruar me kontratë në datën 01.01.2014, në pozicionin “Drejtor Shërbimesh”
- ***** , emëruar me kontratë në datën 01.09.2013, në pozicionin “Inspektor Ndërtimi”

7. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, të revokojë aktet e emërimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, të kërkuar nga nenet 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit e përmendur më poshtë, të ndarë sipas njësive administrative:

- Në Njësinë Administrative Otllak, për punonjësit:

- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Specialist i Urbanistikës", me kontratë pune të datës 31.12.2014;
- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Administrator i Zyrës së Ndhmës Ekonomike", me aktin nr. 14, datë 28.02.2014;
- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Inspektore e Pyjeve", me aktin nr. 13, datë 28.02.2014;
- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Juriste", me aktin nr. 9/1, datë 13.02.2015;
- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Përgjegjës Shërbimesh", me aktin nr. 47/3, datë 18.10.2014.

- Në Njësinë Administrative Velabisht, për punonjësin:

- ✓ *****, emëruar në pozicionin "Veteriner", me aktin nr. 11/1, datë 08.09.2014.

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura duhet të konsiderohen pozicione të lira për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Berat.

8. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat;

- ✓ Të ndryshojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për nëpunësin *****, emëruar me aktin nr. 9/1, datë 09.04.2013, në pozicionin "Inspektore e Financës" pranë Komunës Otlak, duke nxjerë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si "nëpunës civil në periudhë prove".
- ✓ Të ndryshojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për nëpunësin *****, emëruar në datë 14.01.2014, në pozicionin "Përgjegjës i Degës së Finacës" pranë Komunës Sinjë, duke nxjerë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si "nëpunës civil në periudhë prove".
- ✓ Të ndryshojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për nëpunësin *****, emëruar në datë 20.01.2014, në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së Finacës" pranë Komunës Roshnik, duke nxjerë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si "nëpunës civil në periudhë prove".
- ✓ Njësia Përgjegjëse, të ndryshojë aktin nr. 250/2, datë 06.08.2015, me të cilin *****, është konfirmuar "nëpunës civil" në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave", në komunën Velabisht dhe të përcaktojë statusin e saj si nëpunës civil në periudhë prove. Vlerësimi për konfirmimin e kësaj nëpunëseje duhet të bëhet pasi të përfundohet me sukses trajnimi i detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike.

9. Të plotësohen dosjet e personelit, sipas konstatimeve të evidentuara në aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil".

10. *Me hartimin e strukturës përfundimtare njësia përgjegjëse, për njësitë administrative Otllak, Sinjë, Roshnik dhe Velabisht, duhet të bëjë një ndarje të qartë mes pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil dhe njësite direkte të shërbimit, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

11. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijëni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në detyrat dhe orientimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 54, datë 06.05.2016, të Komisionerit, me Vendimin Nr. 114, datë 04.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 54, datë 06.05.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 08.05.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Berat.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Berat dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 326/2 prot., datë 04.05.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin datë 08.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personi i kontaktit të institucionit të Bashkisë Berat, në pozicionin e Përgjegjës të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2, të Vendimit u konstatua se njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit “Nëpunës Civil”, për 31 nëpunësit të cilët përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:
 1. Me aktin nr. 4344 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialist Auditi;
 2. Me aktin nr. 4345 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
 3. Me aktin nr. 4346 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialist për Sportet;
 4. Me aktin nr. 4347 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialiste Buxheti;
 5. Me aktin nr. 4348 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tregjeve;

6. Me aktin nr. 4349 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Paaftësisë;
7. Me aktin nr. 4350 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Ndihmës Ekonomike;
8. Me aktin nr. 4356 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist Veteriner;
9. Me aktin nr. 4355 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Ndihmës Ekonomike;
10. Me aktin nr. 4351 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Kadastrës;
11. Me aktin nr. 4331 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Sistemit GIS;
12. Me aktin nr. 4334 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist Veteriner;
13. Me aktin nr. 4335 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Financës;
14. Me aktin nr. 4336 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Përgjegjës Auditi;
15. Me aktin nr. 4337 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist për Artet dhe Trashëgiminë Kulturore;
16. Me aktin nr. 4338 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist Jurist;
17. Me aktin nr. 4339 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Ndihmës Ekonomike;
18. Me aktin nr. 4340 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist Financë-Kontabilitet;
19. Me aktin nr. 4341 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë;
20. Me aktin nr. 4342 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Taksave dhe Tregjeve;
21. Me aktin nr. 4343 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Transportit, Emergjencave Civile dhe Shërbimeve;
22. Me aktin nr. 4324 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Statistikave;
23. Me aktin nr. 4325 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Administrimit të Kërkesave dhe Përdorimit të Regjistrit Elektronik;
24. Me aktin nr. 4326 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist i Shërbimeve Sociale;
25. Me aktin nr. 4327 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Rinisë;
26. Me aktin nr. 4328 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit;
27. Me aktin nr. 4329 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialiste e Arkivit;
28. Me aktin nr. 4330 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “*Nëpunës Civil*” në pozicionin Specialist Jurist;

29. Me aktin nr. 4333 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialist për Kontrollin e Projekteve;
30. Me aktin nr. 4332 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialist për Regjistrimin dhe Vlerësimin e Bizneseve;
31. Me aktin nr. 4323 prot., datë 07.07.2016, ***** është deklaruar “Nëpunës Civil” në pozicionin Specialist i Marrëdhënive me Publikun.

Për 6 punonjës nuk janë nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit për shkak se kanë dhënë dorëheqjen nga detyra me aktet e mëposhtme:

1. *****; me detyrë “Drejtores e Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve”, ka dhënë dorëheqjen me aktin nr. 4246 prot., datë 04.07.2016;
2. *****; me detyrë “Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit”, ka dhënë dorëheqjen me aktin nr. 374 prot., datë 26.02.2014
3. *****; me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit”, ka dhënë dorëheqjen me aktin nr. 970 prot., datë 29.04.2015
4. *****; me detyrë “Specialist i Taksave dhe Tregjeve”, ka dhënë dorëheqjen me vendimin nr. 469 prot., datë 23.11.2015
5. *****; me detyrë “Specialist i Taksave dhe Tregjeve”, ka dhënë dorëheqjen me vendimin nr. 253prot., datë 07.08.2014
6. *****; me detyrë “Specialist në Drejtorinë e Koordinimit dhe Shërbimeve”, ka dhënë dorëheqjen me vendimin nr. 369 prot., datë 05.10.2015

Në përputhje me nenin 65 pika 1/c të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për 4 punonjës nuk janë nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë si më poshtë:

1. *****; me detyrë “Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë”;
2. *****; me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës”;
3. *****; me detyrë “Specialist i Taksave dhe Tregjeve”;
4. *****; me detyrë “Specialist i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit”.

Për punonjësen *****; njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit pasi, pas verifikimit të kriterëve të përgjithshme e të posaçme nga ana e kësaj njësie, rezultoi se arsimi i kësaj punonjëseje nuk përputhej me atë që kërkonte pozicioni i punës. Bazuar në strukturën aktuale të Bashkisë Berat, të miratuar me Vendimin Nr. 890, datë 23.12.2016, “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2017”, rezulton se kjo punonjëse ka kaluar në pozicionin “Agjent për Arkëtimin e Taksave dhe Tarifave”, pozicioni i cili nuk përfshihet në fushën e veprimtimit të ligjit për shërbimin civil.

- Në zbatim të pikës 3, të Vendimit paralajmërues dhe rekomandimeve të raportit përfundimtar, njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Berat ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, “nëpunës civil në periudhë prove” për 2 punonjës, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 2, Kreu II “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet” të Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”. Konkretisht:

1. Me vendimin nr. 197 prot., datë 25.06.2014, ***** është deklaruar “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin Specialiste Finance në Drejtorinë e Financës.
2. Me vendimin nr. 171 prot., datë 22.05.2015 ***** është deklaruar “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin Specialiste Auditi në Drejtorinë e Financës.

Grupi i punës nga verifikimi i kryer në Bashkinë Berat konstatoi se, njësia përgjegjëse nuk ka realizuar procedurën e deklarimit të statusit të punësimit “*nëpunës civilë në periudhë prove*” për 4 punonjës (*****), pasi kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit për shkak të dorëheqjes, parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 152/2013.

Punonjësit ***** nuk i është deklaruar statusi i punësimit “*nëpunës civil në periudhë prove*” për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, në bazë të vendimit nr. 166 prot., datë 29.05.2015, të Bashkisë Berat.

Për 2 punonjës (***** dhe *****) nuk është deklaruar statusi i punësimit “*nëpunës civil në periudhë prove*”, pasi pozicioni “*Specialistë të Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve*” nuk është pjesë e shërbimit civil, me Vendimin Nr. 890, datë 23.12.2016, “*Për miratimin e Strukturës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2017*”. Për shkak të ndryshimeve që ka pësuar struktura organike e kësaj njësie, ky pozicion është ekuivalentuar si “*Agjent për Arkëtimet e Taksave dhe Tarifave të Familjeve në lagjet e qytetit*”, pozicioni punë që nuk përfshihet në shërbimin civil.

- Në zbatim të pikës 4, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, me Vendimin Nr. 890, datë 23.12.2016, “*Për miratimin e strukturës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2017*”, ka materializuar në strukturë ndarjen e qartë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga funksionet ndihmëse administrative, sipas përkufizimeve të materializuara në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndyshuar. Në vijim të kësaj pike, pas reformës administrativo-territoriale (procesit të ristrukturimit), në strukturën organike të Bashkisë Berat nuk ekzistojnë më pozicionet për të cilat është kërkuar që të konsiderohen si pjesë e shërbimit civil. Ndërkohë, në këtë strukturë, për njësitë administrative të kësaj bashkie, janë miratuar pozicionet e mëposhtme:

- Njësia Administrative Otllak: 1 pozicion “*Specialist Finance*”.
- Njësia Administrative Sinjë: 1 pozicion “*Specialist Finance*” dhe 1 pozicion “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”.
- Njësia Administrative Roshnik: 1 pozicion “*Specialist Finance*” dhe 1 pozicion “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”.
- Njësia Administrative Velabisht: 1 pozicion “*Specialist Finance*”, 1 pozicion “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*” dhe 1 pozicion “*Specialist Taksash*”.

Punonjësit që mbajnë këto pozicione, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit janë trajtuar si nëpunës civilë.

- Në lidhje me rekomandimin e bërë në pikën 5 të Vendimit, rezulton se njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, me Urdhrin nr. 253, datë 06.08.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, për punonjësit si më poshtë të ndarë sipas Njësive Administrative:

Njësia Administrative Otlak:

1. ***** , “Përgjegjës Administrate”
2. ***** , “Inspektor i Tatim Taksave”
3. ***** , “Inspektor i Tatim Taksave”

Përsa i përket punonjësit ***** , me Vendimin Nr. 182, datë 25.02.2016, i është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.

Njësia Administrative Sinjë:

Nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat na është komunikuar se marrëdhënia e punësimit për punonjësin ***** nuk vazhdon për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se akti administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk disponohet nga njësia përgjegjëse e këtij institucioni për shkak se dosja nuk është sjellë nga Njësia Administrative Sinjë.

Njësia Administrative Roshnik:

Nga procesverbali i mbajtur nga grupi i punës dhe personi i kontaktit pranë Bashkisë Berat (punonjësi i menaxhimit të burimeve njerëzore), rezulton se punonjësi ***** aktualisht është në pozicion pune jashtë shërbimit civil. Mosrespektimi me korrektësi i rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

Njësia Administrative Velabisht:

Me Urdhrin Nr. 251, datë 06.08.2015, janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit për këto punonjës:

1. ***** – “Inspektor Tatimesh”
2. ***** – “Administrator i ndihmës Ekonomike”
3. ***** – “Inspektor Pyjesh”
4. ***** – “Topograf”

Përsa i përket punonjësit ***** , marrëdhëniet e punësimit janë ndërprerë para reformës territoriale dhe njësia përgjegjëse e institucionit, nuk administron dosjen e këtij punonjësi.

Nga sa më sipër, rezulton se marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të njësive Otlak dhe Velabisht kanë përfunduar përpara datës së daljes së vendimit të Komisionerit, objekt i këtij verifikimi. Ato nuk kanë mundur të evidentohen dhe më pas të trajtohen nga grupi i mbikëqyrjes, pasi nuk i janë vënë në dispozicion këtij të fundit në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes në subjekt. Nga shqyrtimi i këtyre akteve konstatohet se kjo njësi ka pasur kuptim të gabuar të ligjit, kur ndërprerjen e kësaj marrëdhënieje për 3 punonjësit e njësisë administrative Otlak dhe 4 punonjësit e

njesisë administrative Velabisht e ka bërë me një akt kolektiv, për shkak të ristrukturimit (shkrijës së komunave dhe ristrukturimit të Bashkisë Berat). Në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo vendimmarrje (përfshi ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit) për nëpunësit civil duhet të kryhet në mënyrë individuale. Kjo parregullsi duhet të mbahet parasysht nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

Shpallja e këtyre pozicioneve si të lira nuk është kryer pasi, pas ristrukturimit të Bashkisë Berat këto pozicione nuk ekzistojnë më në strukturën e institucionit.

- Në lidhje me rekomandimin e bërë në pikën 6 të Vendimit paralajmërues të Komisionerit, për punonjësit, të cilët u gjenden në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, të cilët plotësojnë kriteret dhe nuk iu është deklaruar statusi i punësimit, nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat janë ndërmarrë veprimet e mëposhtme administrative:

Njësia Administrative Otlak:

Punonjësja ***** është dorëhequr me datë 12.04.2016, provuar nga librezja e punës, fotokopje e së cilës është administruar nga grupi i punës.

Me Urdhrin Nr. 253, datë 06.08.2015, janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit për punonjësën ***** në pozicionin “Inspektor Finance”, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore për vendin e punës.

Njësia Administrative Sinjë:

Me Urdhrin Nr. 255, datë 06.09.2015, për punonjësin ***** është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit për shkak të ristrukturimit. Ndërkohë gjatë verifikimit në subjekt është konstatuar se ky punonjës nuk përmbushte as kriterin arsimor që kërkonte pozicioni i punës. Pavarësisht largimit për shkak të ristrukturimit, punonjësit nuk i janë njohur të drejtat e sanksionuara nga neni 50 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në vijim, njësia përgjegjëse duhet të mbajë parasysht që në aktet e largimit të përcaktojë motivacionin e duhur, në përputhje me ligjin.

Njësia Administrative Velabisht:

Me shkresën nr. 3351/5 prot., datë 27.07.2016, “Dërgim Informacioni në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 54, datë 06.05.2016”, drejtuar Komisionerit, për punonjësit ***** dhe ***** është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit përpara reformës Administrativo - Territoriale. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se akti administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk disponohet nga njësia e burimeve njerëzore të këtij institucioni për shkak se dosja nuk është sjellë nga njësia administrative Velabisht.

Për punonjësit të cilët duhet të deklaroheshin “nëpunës civil në periudhë prove”, situata është si më poshtë:

Në njësinë administrative Sinjë punonjësit ***** i është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit përpara reformës Administrativo-Territoriale. Akti administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk disponohet nga njësia e

burimeve njerëzore të këtij institucioni për shkak se dosja nuk është sjellë nga njësia administrative Sinjë.

Në njësinë administrative Velabisht, me aktin nr. 4354 prot., datë 07.07.2016, punonjëses ***** i është deklaruar statusi i punësimit si “*nëpunës civil në periudhë prove*”. Për punonjësin *****, nuk është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit “*nëpunës civil në periudhë prove*” për shkak të nivelit arsimor *Bachelor*.

Me Urdhrin Nr. 251, datë 06.08.2015, ***** i është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit për shkak të mospërputhjes së diplomës (punë sociale) me atë që kërkon pozicioni i punës “*Inspektor ndërtimi*”.

- Në zbatim të pikës 7 të vendimit, Kryetari i Bashkisë Berat, me Urdhrin Nr. 253, datë 06.08.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në Njësinë Administrative Otlak për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, pa kryer më parë procedurat e konkurrimit, si më poshtë:

- ✓ *****, në pozicionin “*Specialist i Urbanistikës*”;
- ✓ *****, në pozicionin “*Administrator i Zyrës së Ndhmës Ekonomike*”;
- ✓ *****, në pozicionin “*Inspektore e Pyjeve*”;
- ✓ *****, në pozicionin “*Juriste*”;
- ✓ *****, në pozicionin “*Përgjegjës Shërbimesh*”;

Në rastet e përmendura më sipër, pavarësisht se nga ana e Bashkisë Berat janë bërë përpjekje për vendosjen e ligjshmërisë, duhen mbajtur parasysh dy aspekte: *së pari*, përveç ndërprerjes së marrëdhënies së kundërligjshme të punësimit, duhej bërë edhe revokimi i akteve të emërimit, dhe *së dyti*, sikundër është konstatuar edhe në rastin e zbatimit të pikës 5 të vendimit, akti për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit duhet të jetë individual. Të dy këto aspekte duhet të mbahen parasysh nga institucioni i Bashkisë Berat dhe njësia përgjegjëse e tij, në veçanti, si njësia që ligji për nëpunësin civil ngarkon me administrimin e shërbimit civil, që të mos përsëriten më në të ardhmen.

Në njësinë administrative Velabisht, me Vendimin Nr. 414, datë 07.06.2016, punonjësi *****, në pozicionin “*Veteriner*”, është larguar me motivacionin “*Për shkelje në mënyrë të përsëritur të disiplinës në punë*”.

Shpallja e këtyre pozicioneve si të lira nuk është kryer pasi, pas ristrukturimit të Bashkisë Berat këto pozicione nuk ekzistojnë më në strukturën e institucionit.

- Në zbatim të pikës 8 të Vendimit paralajmërues të Komisionerit, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat, në lidhje me rekomandimin për ndryshimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimit nga “*nëpunës civil*” në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, ka vepëruar si më poshtë:

- ✓ Në përputhje me nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për Nëpunësin civil*”, i ndryshuar, punonjësi ***** me aktin nr. 4352/1 prot., datë 07.07.2016, është deklaruar “*nëpunës civil në periudhë prove*”.

- ✓ Në përputhje me nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin civil” (i ndryshuar) punonjësi ***** me aktin nr. 4353 prot., datë 07.07.2016 është deklaruar “ nëpunës civil në periudhë prove”.

Referuar aktit nr. 325 prot., datë 05.05.2016, punonjësit ***** nuk i është bërë ndryshimi i deklarimit të statusit të punësimit për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë. Ndërsa punonjësit ***** me Urdhrin Nr. 253, datë 06.08.2015, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në Njësinë Administrative Otllak për shkak të mospërputhjes së diplomës (gjuhë-letërsi) me atë të pozicionit të punës (i cili kërkon që punonjësi të jetë i diplomuar për shkenca ekonomike).

- Në zbatim të pikës 9, të Vendimit të Komisionerit, bazuar në konstatimet e evidentuara në aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”, rezultoi se njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat i kishte plotësuar dosjet e personelit në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat, në zbatim të pikës 10 të vendimit të Komisionerit, për njësitë administrative Otllak, Sinjë, Roshnik dhe Velabisht, ka bërë një ndarje të qartë mes pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil dhe njësite direkte të shërbimit, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil. Kjo ndarje është materializuar në Vendimin Nr. 890, datë 23.12.2016, “Për miratimin e strukturës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2017”.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 54, datë 06.05.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat”, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e vendimit të Komisionerit. Ashtu sikundër u evidentua edhe më sipër në përmbajtjen e këtij materiali, problemet apo parregullsitë e konstatuara në mënyrën e zbatimit të këtij vendimi, duhet të mbahen parasysh nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Berat, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 54, datë

06.05.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Berat”.

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Berat dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA